

Kosova bëhet me ambasadë në Emiratet e Bashkuara Arabe



FLET PËR "EPOKËN E RE", PRENK GJETAJ ■ FAQE 4-5

Vetëm presioni ndërkombëtar detyron Serbinë t'i tregojë varrezat masive



Kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Prentk Gjetaj, ka bërë me dije se Serbia vetëm e detyruar nga bashkësia ndërkombëtare mund të tregojë për fatin e personave të zhdukur. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se BE-ja duhet ta kushtëzojë integrimin evropian të Serbisë me çështjen e personave të zhdukur. Gjetaj ka treguar se hapja e arkivave ushtarake dhe policore serbe do ta ndihmonte shumë

këtë proces. Mirëpo, sipas tij, këto arki-va mund të hapen vetëm me lejen e politikës serbe. Gjetaj është shprehur i bindur se ky vullnet i Serbisë nuk vjen në shprehje pa një presion të madh ndërkombëtar

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**ASGJË NUK ËSHTË TRESHI
APO DHJETËSHI KRAHASUAR
ME KAQUSHËN
DYMBËDHJETËTYTËSHE!** F. 11

BEHXHET SH.
SHALA - BAJGORA



**PARALAJMËROHET NGRITJA
E PAGAVE NË SEKTORIN E
SHËNDETËSISË** F. 5

**NIS DEBATI PËR
PROFILIZIMIN E MËSUESVE** F. 6

EKONOMI

**MILIONË DOLLARË NDIHMË
PËR PËRMIRËSIMIN
E MJEDISIT TË BIZNESIT** F. 9

**BIE ÇMIMI I PRODHIMEVE
BLEGTORALE** F. 9

KULTURË

**VLERA HISTORIKE DHE
FILOZOFIKE-KOMBËTARE
E LUFTËS SË UÇK-SË
1991-1999 NUK GUXON TË
NËPËRKËMBET** F. 16

PROF. DR. HAKIF BAJRAMI

SPORT

**DRITA E MOBILIZUAR PËR
FITORE NDAJ '89-SHIT** F. 14

**MKRS-ja, 12 MIJË EURO
MAJLINDA KELMENDIT** F. 14

Wieland: Mos premtoni data për liberalizimin e vizave



Zëvendëspresidenti i Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, gjatë vizitës së tij në Kosovë, i ka porositur liderët të mos bëjnë premtime sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave. Eurodeputeti gjerman ka thënë se aktualisht topi për këtë çështje është në anën e Komisionit dhe Këshillit, e jo te Parlamenti Evropian

Analistët: PSD-ja mund të marrë elektorat nga të gjitha partitë

Njohësit e proceseve politike kanë komentuar në mënyra të ndryshme funksionimin e Partisë Socialdemokrate (PSD) nën drejtimin e strukturave të reja. Politologu

Ramush Tahiri ka thënë për gazetën "Epoka e re" se deputetët e larguar nga Vetëvendosje mund ta ringjallin PSD-në. Sipas tij, ky subjekt mund të marrë elektorat nga të gjitha partitë ■ FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

CIA: Programi ambicioz i Shqipërisë për rritjen e ekonomisë dhe investimeve

WASHINGTON, 10 MAJ - Shqipëria, dikur një shtet i mbyllur me ekonomi të planifikuar, është një vend me ekonomi të hapur të tregut dhe moderne, shkruan Agjencia Qendrore e Inteligjencës (CIA) në raportin e saj për Shqipërinë. Shqipëria arriti ta kalojë valën e parë të krizës financiare, por efektet negative të krizës shkaktuan ngadalësim të konsiderueshëm të ekonomisë.

Që prej vitit 2014 ekonomia e Shqipërisë është përmirësuar dhe ka arritur një rritje prej 3.8 % në vitin 2017. Që prej vitit 2015 Shqipëria ka filluar një program ambicioz për ta rritur mbledhjen e taksave dhe për të futur sa më shumë sipërmarrje në ekonominë formale. Ndërsa në korrik 2016, Shqipëria kaloi një amendament kushtetues për ta reformuar sistemin e drejtësisë, për ta forcuar shtetin e së drejtës dhe ta

reduktuar korupsionin. Gjithashtu, në këtë raport evidentohej edhe reformat e ndërmarrja në sistemin energjetik në vend. "Kohët e fundit Qeveria ka ndërmarrë hapa për t'i bllokuar humbjet jo për arsye teknike dhe ka filluar ta përmirësojë rrjetin e shpërndarjes. Forcimi i kontratave të elektricitetit ka përmirësuar vijueshmërinë e sektorit, duke ulur varësinë e tij nga buxheti. Gjithashtu, me ndihmën e donatorëve

ndërkombëtarë Qeveria po zhvillon hapa për ta përmirësuar rrjetin hekurudhor të vjetruar, një barrierë prej shumë kohësh për rritjen ekonomike".

Investimet e huaja janë rritur ndjeshëm vitet e fundit pasi Qeveria ka ndërmarrë një program ambicioz për ta përmirësuar klimën e biznesit nëpërmjet reformave fiskale dhe legjislative. Qeveria është fokusuar në një thjeshtësim të kërkesave për licencim dhe



kodit të taksimit si dhe ka arritur një marrëveshje të re me FMN-në për më shumë mbështetje teknike dhe financiare.

Rama: Kërkojmë vetëm atë që kemi arritur me reformat tona

Sa i përket anëtarësimit në BE dhe zgjerimit të Unionit, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se "po kërkojmë vetëm atë që kemi arritur me reformat dhe përpjekjet tona, hapjen e negociatave"



mundshëm të shqiptarëve drejt vendeve të pasura të Unionit. Për sa i përket të ashtuquajturës banda shqiptare e identifikuar nga Agjencia Kombëtare e Krimeve në Britaninë e Madhe,

kryeministri tha se "kam dëgjuar shumë nga këto teori gjatë fushatës së "Brexit" por, siç të dhënat zyrtare flasin qartë, shumë prej tyre janë vetëm ekzagjerime për qëllime të caktuara politike". "Unë nuk po e mohoj këtë problem, por e kemi dëgjuar këtë lloj etiketimi edhe më parë në histori. Një herë e një kohë, italianët në Amerikë shiheshin vetëm si picamenë dhe mafiozë, por e vërteta ishte shumë më komplekse. Nuk duhet të harrojmë që krimi i organizuar nuk është një fenomen kombëtar, i kufizuar brenda kufijve

shtetërorë. Është një fenomen mbarëkombëtar. Kriminelët kanë Bashkimin e tyre Evropian, kjo është arsyeja përse Bashkimi ynë Evropian duhet të jetë sa më i fortë dhe i ndërlidhur që të jetë e mundur, për të luftuar në mënyrë të suksesshme kundër krimit", nënvizoi Rama për BBC. Sa i përket anëtarësimit në BE dhe zgjerimit të Unionit, kryeministri deklaroi se "tani për tani ne po kërkojmë vetëm atë që kemi arritur me reformat dhe përpjekjet tona: hapjen e negociatave. Anëtarësimi për ne dhe për vendet e tjera të rajonit do të ndodhë më vonë, jo sot".

TIRANË, 10 MAJ - "Anëtarësimi në BE i Shqipërisë përfaqëson mbrojtjen e vetes nga fantazmat e të shkuarës, duke garantuar që nuk do të përballemi sërish në të ardhmen me atë që u përballëm në të shkuarën e afërt", deklaroi kryeministri Edi Rama në një intervistë në programin radiofonik "Today" të "BBC". Kreu i Qeverisë shqiptare thek-

soi se "ne po kërkojmë hapjen e negociatave, të cilat nuk kanë asnjë kosto për BE-në, por janë jetike për ne". "Retorika e frikës rreth fluksit të emigracionit, që ka të bëjë aspak më shumë se me lëvizjen e lirë të njerëzve në tregun e lirë të punës, minon vlerat dhe parimet e botës sonë evropiane", u shpreh Rama në përgjigje të shqetësimeve lidhur me emigrimin dhe largimin e

Kosova bëhet me ambasadë në Emiratet e Bashkuara Arabe



PRISHTINË, 10 MAJ - Republika e Kosovës ka hapur ambasadën e vet në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA). Në ceremoninë e prerjes së shiritit të kësaj ambasade kanë marrë pjesë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli dhe eksponentë të tjerë nga Qeveria e EBA-s.

Ministri Pacolli ka thënë se Ambasada e Republikës së Kosovës në EBA është e para në shtetet e golfit që paraqesin një fuqi shumë të madhe

ekonomike. "Emiratet e Bashkuara ishte shteti i parë arab që e njohu Kosovën, që mori pjesë në aksionin e post konfliktit në Kosovë, për një kohë ishte pjesë e KFOR-it. Emiratet e Bashkuara ndërtuan infrastrukturën aeroportuale në Kukës për t'u dalë në ndihmë të dëbuarve nga Kosova. Emiratet e Bashkuara kanë ndihmuar dhe vazhdojnë të ndihmojnë Kosovën edhe ekonomikisht duke ndërtuar shkolla, spitale dhe duke rinovuar objektet e kultit", ka thënë Pacolli.

Meta: Për negociata duhet bashkëpunim mes palëve

TIRANË, 10 MAJ - Nga Gjirokastra, kreu i shtetit Ilir Meta ka folur për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian. Ai shprehu optimizëm, ndërsa bëri apel për bashkëpunim në mënyrë që në qershor të kemi një vendim poz-

itiv nga Këshilli Evropian. "Besoj se janë të gjitha mundësitë deri në qershor duke u përqendruar të gjithë në ato kërkesa të cilat dihen se kanë të bëjnë me përparësitë kyçe të këtij procesi. Duke bashkëpunuar të gjithë,

jam i bindur se është tërësisht e mundshme që rekomandimi pozitiv i Komisionit Evropian të shoqërohet nga një vendim pozitiv i Këshillit të vendeve anëtare", theksoi presidenti Ilir Meta. I pyetur si i konsideron lëvizjet e

fundit në Prokurori, Meta nuk preferoi të përgjigjej. "Nuk kam asnjë koment përveç sezonit turistik, i cili ka filluar shumë mbarë si në Skrapar, Përmet, edhe sot në Gjirokastër", deklaroi Ilir Meta.



Analistët: PSD-ja mund të marrë elektorat nga të gjitha partitë

Njohësit e proceseve politike kanë komentuar në mënyra të ndryshme funksionimin e Partisë Socialdemokrate (PSD) nën drejtimin e strukturave të reja. Politologu Ramush Tahiri ka thënë për gazetën "Epoka e re" se deputetët e larguar nga Vetëvendosja mund ta ringjallin PSD-në. Sipas tij, ky subjekt mund të marrë elektorat nga të gjitha partitë. Kurse analisti politik Mazllum Baraliu ka shprehur skepticizëm për suksesin e PSD-së me strukturën e re politike. Ai ka thënë për gazetën se kjo parti mund të marrë elektorat nga partitë e tjera, por jo edhe elektoratin bazë të Vetëvendosjes



elektorati dëshiron ndasi, mirëpo dëshiron konsolidim dhe fuqizim të partisë dhe besnikëri. Përafërsisht kështu mund të ndodhë edhe me PSD-në", ka deklaruar Baraliu.

Megjithatë, Baraliu ka thënë se dyshon që drejtuesit e ri të PSD-së t'i marrin votat që i kanë marrë në kuadër të Vetëvendosjes. "Zgjedhjet e para do të dëshmojnë se sa ata kanë fuqi politike. Kam dyshim se mund t'i kenë kaq deputetë dhe kaq votat që i kanë marrë në Vetëvendosje t'i marrin edhe në PSD. Por, mbetet të shihet dhe unë ju uroj shumë suksese në këtë drejtim", ka theksuar Baraliu. Ai ka vlerësuar se Kosova ka më së shumti nevojë për socialdemokraci dhe, sipas Baraliut, PSD-ja do të ishte mirë t'u qëndronte besnike vlerave të socialdemokracisë edhe në veprime. "Kemi nevojë për socialdemokraci, por se sa socialdemokracia kuptohet te ne është çështje që duhet t'i lihet për gjykim opinionit publik që ta vlerësojë punën e tyre gjatë viteve. Mbi të gjitha, duhet parë veprimet e tyre kur janë në pushtet dhe në opozitë se sa i mbrojnë parimet e socialdemokracisë, barazinë qytetare, mbrojtjen sociale dhe kujdesin social të qytetarët. Tri parti janë të paktën me orientim socialdemokrat: Vetëvendosja, Nisma dhe PSD-ja, por nuk shohim politika të tilla që shkojnë për ndërtimin e parimeve bazë të socialdemokracisë që janë: barazia qytetare, barazia sociale, prosperiteti, ekonomia prodhuese e kështu me radhë", ka theksuar Baraliu.

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 MAJ - Politologu Ramush Tahiri ka thënë të enjten për gazetën "Epoka e re" se deputetët e larguar nga Lëvizja Vetëvendosje mund ta ringjallin Partinë Socialdemokrate (PSD). "Grupi i Deputetëve të Pavarur ka bërë mirë që ka marrë drejtimin e Partisë Socialdemokrate me traditë prej vitit 1990. PSD-ja ka mbijetuar duke bartur orientim socialdemokrat dhe bindje socialdemokrate. Grupi i Deputetëve të Pavarur me të drejtë ka vlerësuar se nuk ka nevojë që në skenën politike të shpikët ndonjë parti e re, sepse nga përvoja e kaluar me partitë e tjera është parë se nuk është shumë e leverdishme si koncept. Tash kemi PSD-në me njerëz të rinj që janë dëshmuar në skenën politike në kuadër të Vetëvendosjes, të partive të tjera dhe në shoqëri civile. Kjo strukturë mund ta ringjallë PSD-në", ka deklaruar Tahiri.

Ai ka theksuar se Kosova ka nevojë për modele të pastra ideologjike të partive. Tahiri ka shtuar se për Kosovën do të ishte mirë që PSD-ja të kishte sukses në zgjedhje. Madje, sipas tij, ky subjekt mund të marrë elektorat nga të gjitha partitë. "Modele të pastra ideologjike të partive nuk kemi. Në këtë koncept është mirë që njerëzit e rinj me PSD-në, pra me mandatet në Kuvend dhe me qeverisjen në dy komuna, Prishtinën dhe Kamenicën, duan të fusin një frymë të re dhe një garë ideologjike. Sa do të kenë sukses varet prej qëllimeve dhe idealit me të cilin kanë hyrë në politikë dhe jo prej pragmatizmit politik. Për Kosovën do të ishte mirë që PSD-ja të kishte sukses. Socialdemokracia nuk duhet të lidhet me të kaluarën, sepse pas pavarësimit të Kosovës mund ta lidhim individualisht dikë, por nuk mund ta lidhim si koncept apo si vazhdimësi të një partie tjetër. Nëse animojnë në socialdemokraci mendoj se PSD-ja mund të bëhet parti

dominante në skenën politike. Suksesi i tyre në zgjedhje varet nga ndërtimi i konceptit dhe animimi i programit", është shprehur Tahiri. Ai ka pohuar se Kosova ka nevojë për socialdemokraci. "Konsideroj se socialdemokracia dhe më vonë liberaldemokracia janë partitë e ardhshme të Kosovës dhe është koncepti për të cilin ka nevojë vendi ynë", ka theksuar ai. Ndërsa njohësi i proceseve politike, Mazllum Baraliu, ka shprehur skepticizëm për suksesin e Partisë Socialdemokrate me strukturën e re politike. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se zgjedhjet e ardhshme janë barometri i tyre për ta parë veten ku janë si parti dhe nëse do t'i votojë elektorati. Sipas Baraliut, PSD-ja mund të marrë elektorat nga partitë e tjera, por jo edhe elektoratin bazik të Lëvizjes

Vetëvendosje. "Sipas mendimit tim, nuk mund të priten ndryshime të mëdha dhe besnikëri e madhe e elektoratit, sidomos jo atij bazik të Vetëvendosjes karshi PSD-së së re. Do të shohim nëse do të përfitojë nga ndonjë elektorat i partive të tjera politike. Mbase edhe mund të marrin nga pak nga të gjitha, por nuk mund të paragjykojmë. Zgjedhjet do të jenë një test për të parë se sa do të jenë të konsoliduar si parti. Bazuar në përvojat e deritanishme të të gjithë atyre ndarjeve që janë bërë të subjekteve politike, nuk është që kemi ndonjë rritje të madhe të elektoratit të këtyre partive, madje shpeshherë është parë që ato kanë qenë përpjekje të pasuksesshme dhe afatshkurtra që janë kthyer serish në follenë e tyre duke e kuptuar se jogjithherë

Veseli: Këtë vit ndodh liberalizimi i vizave

Prishtinë, 10 maj (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë të enjten se liberalizimi i vizave do të ndodhë në fund të këtij viti, pasi që Kosova ka përmbyllur të gjitha kriteret të cilat janë dashur për të lëvizur lirshëm. "Ajo që i duhet më së shumti Kosovës është që rinia si ju të qëndrojnë dhe të jetojnë në Kosovë dhe jo të mendojnë që ta gjejë mënyrën e jetesës jashtë vendit. Kjo fuqi e cila është aktualisht e resurseve tona humane, duke arritur ta mbrojmë e ta ruajmë këtu në Kosovë, ne mund ta zhvillojmë pikërisht në temën për të cilën jemi duke folur, iniciativa e tregut të lirë, e cila nuk ka alternativë tjetër, për arsye se Kosova si shtet demokratik, si shtet liberal, ka vetëm iniciativën private si shtytës në më të madhe të lirisë dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës", ka thënë Veseli në një bashkëbisedim me studentët e



Kolegjit UBT, në kuadër të konferencës "Free Market Road Show", që sivjet për moto ka "Vlerat, cilat vlera!" Sipas Veselit, Kosova ka

nevojë për reforma të mëdha ekonomike, ndërsa në të njëjtën kohë ai tha se janë duke i bërë ato. Eksperti dhe analisti Nima

Sanandaji ka theksuar se është me rëndësi jetike të diskutohen tema të tilla, pasi shumë nga krizat me të cilat po përballet

Evropa lidhen me vlerat. "Ideja e këtij edicioni nuk është vetëm për të diskutuar gjëra të zakonshme që lidhen me ekonominë dhe filozofinë e tregut të lirë sepse mendojmë se shumë nga krizat me të cilat përballet dhe do të përballet Evropa në të ardhmen e afërt lidhen me vlerat", ka deklaruar ai. Përfaqësuesi i Qendrës Ekonomike Austriake, Federico Fernandez, ka vlerësuar se gara në tregun e lirë është shumë e shëndetshme në një shoqëri liberale, pasi gara në treg i ndihmon secilit të përmirësohet. "Kur tentojmë ta shmangim konkurrencën, shkatërrojmë ekuilibrin se sa merret dhe sa dhurohet në një treg. Gara siguron që ne të bëhemi versionin më i mirë i vetes sonë, andaj shoqëria që tenton të shmangë garën e tregut është shoqëri që tenton të krijojë njerëz me mendësi mesatare", ka thënë Fernandezi.

Flet për "Epokën e re", Prenk Gjetaj

Vetëm presioni ndërkombëtar detyro

Kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Prenk Gjetaj, ka bërë me dije se Serbia vetëm e detyruar nga bashkësia ndërkombëtare mund të tregojë për fatin e personave të zhdukur. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se BE-ja duhet ta kushtëzojë integrimin evropian të Serbisë me çështjen e personave të zhdukur. Gjetaj ka treguar se hapja e arkivave ushtarake dhe policore serbe do ta ndihmonte shumë këtë proces. Mirëpo, sipas tij, këto arkiva mund të hapen vetëm me lejen e politikës serbe. Gjetaj është shprehur i bindur se ky vullnet i Serbisë nuk vjen në shprehje pa një presion të madh ndërkombëtar

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 MAJ - Kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Prenk Gjetaj, ka mirëpritur miratimin në Kuvend të rezolutës, e cila e obligon Qeverinë e Kosovës që këtë çështje ta bëjë pjesë të dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka bërë me dije se kjo çështje mund të zgjidhet vetëm duke u diskutuar në Bruksel ndërmjet zyrtarëve më të lartë të dy shteteve dhe presionit ndërkombëtar që mund të vijë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në këtë proces vetëm një presion i madh ndërkombëtar mund ta detyrojë Serbinë të ndihmojë në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. "Ajo që dihet është se politika serbe pa ndonjë presion të madh ndërkombëtar nuk bën hapa përpara në këtë drejtim. Pra, pa ndonjë presion ose favor nga bashkësia ndërkombëtare, Serbia nuk do të ndihmojë në zbardhjen e fatit të të pagjeturve", ka thënë Gjetaj. Madje, sipas tij, Brukseli me këtë çështje duhet ta kushtëzojë rrugën e Serbisë drejt BE-së. "Vetëm faktori ndërkombëtar mund ta detyrojë Serbinë në këtë drejtim, askush tjetër. Prandaj, ne vazhdimisht kemi kërkuar dhe kërkojmë që faktori ndërkombëtar të bëjë presion apo ta kushtëzojë Serbinë në rrugën e saj drejt integritetit në BE me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Po e përsëris se vetëm në këtë mënyrë Serbia do të tregonte për vendndodhjen e varrezave masive apo individuale", është shprehur ai.

Gjetaj ka treguar se hapja e arkivave ushtarake dhe policore serbe do ta ndihmonte shumë këtë proces. "Pengesa kryesore ka qenë moshapja e arkivave ushtarake dhe policore nga pala serbe, pastaj mosdhënia e informatave për veprimet që i ka bërë ushtria dhe policia serbe. Pra, për ta ndihmuar këtë proces Serbia duhet të jetë shumë e hapur në këtë drejtim. Sipas informatave tona, Serbia e di për vendndodhjen e varrezave

masive dhe për fatin e 1 650 personave që ende konsiderohen të zhdukur. Natyrisht se në këtë drejtim pengesat i ka shkaktuar politika serbe, sepse vetëm me lejen e saj institucionet serbe mund të japin informacione që ndihmojnë në zbardhjen e fatit të të pagjeturve", ka thënë Gjetaj.

"Epoka e re": Z. Gjetaj, Kuvendi ka miratuar rezolutën për personat e pagjetur, e cila e obligon Qeverinë e Kosovës që këtë çështje ta bëjë pjesë të dialogut Kosovë - Serbi. Si e keni parë këtë hap të Kuvendit?

Gjetaj: Kjo prej kohësh ka qenë kërkesë e familjarëve të zhdukurve, që ne si komision vazhdimisht e kemi mbështetur.

Pra, siç e dini ju, edhe më herët kemi kërkuar që çështja e të pagjeturve të bëhet pjesë e bisedimeve politike ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, sepse kjo çështje nuk është thjesht humanitare, por edhe politike. Vazhdimisht fati i personave të zhdukur ka qenë peng i politikës serbe. Mendoj se ata duhet të jenë më operativë në këtë drejtim, sepse bisedimet e deritashme për këtë çështje që janë zhvilluar me ndërmjetësimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq nuk mund të ecin më tutje. Nuk ka mundësi të bëhet ndonjë hap më radikal në kuptimin e detyrimit të Serbisë për ta treguar vendndodhjen e varrezave masive apo individuale.

"Epoka e re": Përfshirja e kësaj çështje në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi, sa mund t'jua kthej shpresat familjarëve për zbardhjen e fatit të më të dashurve të tyre?

Gjetaj: Sigurisht se përfshirja e kësaj çështje për diskutim në nivelin politik ndërmjet dy vendeve rrit shpresat për zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Ky lloj i bisedimeve mendojmë se do t'i heqë pengesat politike që deri më tani i kemi pasur në këtë proces.

"Epoka e re": Cilat kanë qenë pengesat më të mëdha deri më tani për zbardhjen e fatit të të pagjeturve?

Gjetaj: Pengesa kryesore ka qenë moshapja e arkivave

ushtarake dhe policore nga pala serbe, pastaj mosdhënia e informatave për veprimet që i kanë bërë ushtria dhe policia serbe. Pra, për ta ndihmuar këtë proces Serbia duhet të jetë shumë e hapur në këtë drejtim. Sipas informatave tona, Serbia e di për vendndodhjen e varrezave masive dhe për fatin e 1 650 personave që ende konsiderohen të zhdukur. Natyrisht se në këtë drejtim pengesat i ka shkaktuar politika serbe, sepse vetëm me lejen e saj institucionet serbe mund të japin informacione që ndihmojnë në zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

"Epoka e re": Kush mund ta detyrojë politikën serbe që ajo



n Serbinë t'i tregojë varrezat masive



një kërkesë e jona. Kjo ka pasur të bëjë për germimin në Rudnicë të Rashkës, ku doli se patëm të drejtë, sepse në atë varrezë masive u gjetën mbi 50 persona. Normalisht se Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka për mision humanitetin, kurse njerëzit që janë kidnapuar, vranë dhe masakruar nuk u ka ndodhur ajo për çështje humane. Prandaj, këtë proces e mban peng politika serbe dhe ajo mund ta ndihmojë. Ne e falënderojmë Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq

për angazhimin dhe vullnetin e mirë në këtë drejtim, mirëpo pa presion ndaj Serbisë kjo çështje nuk mund të zgjidhet.

"Epoka e re": Ju keni pasur dyshime në disa vende të caktuar për varreza masive në Serbi. Tani keni ndonjë informatë apo dyshim për ndonjë lokacion të ri ku mund të ketë varrezë masive?

Gjetaj: Ne i kemi disa vende që me kohë i kemi prezantuar si lokacione të dyshimta, mirëpo pikërisht ato vende nuk janë

përfshirë në agjendë për germime. Për shembull, te Rudnica është një vend aty, ku ne kemi dyshime, por ky vend nuk është përfshirë në agjendën e germimeve. Arsyetimi i tyre ka qenë se nuk kanë informacione të plota për pikën e caktuar. Po ashtu, kemi edhe informacione për lokacione të tjera të dyshimta, por të cilat pala serbe nuk i ka përfshirë në agjendën e germimeve. Kështu që, ne po presim që pala serbe të bëjë ndonjë hap konkret në lokacionet që ne kemi dyshime.

Paralajmërohet ngritja e pagave në sektorin e shëndetësisë

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Gjendja në sektorin e shëndetësisë ka ndryshuar dukshëm. Sot në shëndetësinë e Kosovës ka më shumë seriozitet, dinamikë të punës dhe rezultate. Ky konstatim doli pas një takimi pune që kryeministri Ramush Haradinaj ka zhvilluar të enjten me ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili. Gjatë kësaj vizite, kryeministri Haradinaj është njoftuar për gjendjen në sektorin e shëndetësisë, për reformat në këtë sektorë të ndjeshëm, të cilat kanë për qëllim vendosjen e rendit dhe rregullit në shëndetësinë në vendin tonë. "Shëndetësia ka qenë tema e parë me prioritet që nga fillimi i punës sonë si Qeveri. Falënderoj ministrin për marrjen me seriozitet të kësaj teme dhe kësaj sot mund të konstatojmë se gjendja në sektorin shëndetësor është ndryshe, ka më shumë seriozitet, dinamikë dhe rezultate", ka thënë kryeministri Haradinaj pas takimit me

ministrin Ismaili. Edhe në këtë vizitë kryeministri Haradinaj i cilësoi mjekët heronj të Kosovës, duke thënë se atyre duhet t'u jepet dinjiteti, në radhë të parë profesional dhe njerëzor, por edhe material. "Jemi bashkë në këtë proces edhe për rishikimin të buxhetit edhe për planifikim për vitin që vjen. Pra, nuk do të ndalemi ta arrijmë rezultatit. Jam optimist se do ta arrijmë këtë dhe për këtë ju siguroj se do të qëndrojmë bashkë. Tani është koha t'i ecim punët", ka thënë Haradinaj. Kryeministri Haradinaj dhe ministri Ismaili thanë se po bëhen punë serioze që të vendoset rregull në listën esenciale të barnave. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, vizitën e kryeministrit e cilësoi si ditë të veçantë për Ministrinë e Shëndetësisë. Me këtë rast, ministri Ismaili ka thënë se vizitat që bashkërisht me kryeministrin i ka bërë në QKUK dhe kjo vizitë në Ministri të

Shëndetësisë, tregon se ky sektor ka një vëmendje të veçantë nga Qeveria. "U zotua se do të bëjmë zgjidhje në sektorin e shëndetësisë, se do t'i mbështesim punëtorët shëndetësorë me ngritje të pagave, me një sistem më të mirë të menaxhimit, do t'i mbështesim edhe kuadrot, ashtu siç bëmë ditë më parë edhe me specializantët. Pra, jemi duke bërë hapa gradualë, por të vendosur dhe me fokus që shëndetësia në Kosovë, nën mandatin e kësaj Qeverie, të përmirësohet dukshëm nga ajo që kemi gjetur", ka thënë ministri Ismaili, duke falënderuar kryeministrin Haradinaj për angazhimin dhe përkrahjen që ia ka dhënë këtij sektori. Gjatë kësaj vizite kryeministri Haradinaj takoi edhe drejtorët e departamenteve të MSH-së dhe krerët e institucioneve vartëse të saj, nga të cilët kërkoi besim dhe përkushtim në punën me të cilët janë ngarkuar, si pjesë e nismës së përbashkët për ta ndryshuar gjendjen në shëndetësi.

pastaj ta ndihmojë këtë proces?

Gjetaj: Ajo që dihet është se politika serbe pa ndonjë presion të madh ndërkombëtar nuk bën hapa përpara në këtë drejtim. Pra, pa ndonjë presion ose favor nga bashkësia ndërkombëtare, Serbia nuk do të ndihmojë në zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Vetëm faktori ndërkombëtar mund ta detyrojë Serbinë në këtë drejtim, askush tjetër. Prandaj, vazhdimisht kemi kërkuar dhe kërkojmë që faktori ndërkombëtar të bëjë presion apo ta kushtëzojë Serbinë në rrugën e saj drejt integritetit në BE me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Po e përsëris se vetëm në këtë mënyrë Serbia do të tregonte për vendndod-

hjen e varrezave masive apo individuale.

"Epoka e re": Po në këtë procesin e deritashëm të bisedimeve të ndërmjetësuar nga Kryqi i Kuq, cili ka qenë vullneti i palës serbe për të ndihmuar në zbardhjen e kësaj çështje?

Gjetaj: Ne vazhdimisht në këtë proces jemi angazhuar, kemi shkëmbyer ide, informacione, mirëpo krejt kjo është bërë në bazë të një "vullneti të mirë". Në fakt, nuk ka ekzistuar vullneti i mirë nga pala serbe. Do të thotë, shumë kërkesa tona në këtë proces kanë mbetur pa përgjigje. Sa për ilustrim po ju tregoj se ka pasur raste kur kemi shkuar deri në ndërprerje të bisedimeve për të na u plotësuar



Ndahen çmimet 'Shkencëtar i ri i vitit 2018'



rave në shkencë", është shprehur ministri Bytyqi.

Nxënësit të cilët janë shpërblyer me çmimin "Shkencëtar i ri i vitit 2018" janë: Art Berisha, nxënës i Gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë, Altina Aliu, nxënëse e Gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë, Redon Duraj, nxënës i Gjimnazit "Ahmet Gashi" në Prishtinë, Shkodran Hasani, nxënës i Gjimnazit "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj, Çlirimtare Ramadani, nxënëse e Gjimnazit "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj dhe Enis Vladi, nxënës i Gjimnazit "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj.

Nxënësit Art Berisha dhe Shkodran Hasani janë shprehur falënderues për ndarjen e çmimit, ndërkohë kanë thënë se çmimi do të jetë edhe motiv për angazhime të tjera në fushën e shkencave natyrore në të ardhmen.

Vendin e parë nga Komuna e Prishtinës e ka zënë Art Berisha nga Gjimnazi "Sami Frashëri", vendin e dytë Altina Aliu po nga kjo shkollë, kurse vendi i tretë Redon Durajt nga Shkolla e Mesme e Lartë "Ahmet Gashi"

Nis debati për profilizimin e mësuesve

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Drejtorja e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe me përfaqësuesit e Fakultetit të Edukimit të Universitetit "Hasan Prishtina", ka organizuar debat publik lidhur me profilizimin e mësuesve të ciklit klasor I-V, nismë kjo e vitit të kaluar, me të cilën synohet të arrihet një mësues/e për klasë.

Për këtë çështje kanë filluar të zhvillohen debatet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës për ta kuptuar opinionin e gjithë aktorëve të përfshirë në procesin arsimor çështje. Po ashtu, edhe Fakulteti i Edukimit është duke e realizuar një hulumtim dhe shumë shpejt do të dalë me një vlerësim të përgjithshëm.

Një debat me karakter të tillë u

zhvillua edhe në kryeqendër, ku pjesëmarrës ishin drejtuesit e 42 institucioneve edukativo-arsimore të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët dhe 70 mësues/e të secilës shkollë të Komunës së Prishtinës, për ta kuptuar perceptimin dhe mendimin e tyre rreth kësaj nisme.

Diskutuesit shprehën mendime dhe këndvështrime të ndryshme lidhur me profilizimin e mësuesve, në përgjithësi përkrahen idenë, duke konsideruar se kjo do të

reflektonte drejtpërsëdrejti për specializimin e mësuesve dhe përmirësimin e ngritjes së cilësisë në arsim. Kjo iniciativë e institucioneve përgjegjëse të arsimit, për profilizimin e mësuesve të klasave I-V, është si rezultat i zhvillimeve të hovshme bashkëkohore në sferën e arsimit dhe kërkesë për t'iu përgjigjur zhvillimeve të kohës për një mësimdhënës dhe mësimnxënie cilësore, sipas standardeve bashkëkohore.



Fillon shpërndarja e certifikatave për statusin veteran pjesëtar

**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 10 MAJ - Zyra për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (ZÇKL) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se ka filluar shpërndarja e certifikatave për statusin veteran pjesëtar. Certifikatat do të shpërndahen nga komandantët e njësive, zyrat e shoqatave të dala nga lufta apo nga Zyra për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës.

Në këtë komunikatë është bërë me dije se në javët në vazhdim do të përmbyllet edhe pajisja me certifikata e veteranëve pjesëmarrës. "Zyra për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka filluar shpërndarjen e certifikatave për statusin veteran pjesëtar. Ky proces vijon pas përmbylljes së problemeve teknike, me të cilat ZÇKL është duke punuar që prej shtatorit 2017. Vlen të ceket se që nga dhjetori 2017 ZÇKL ka filluar pajisjen me dokumentacionin e

nevojshëm për veteranët invalidë dhe familjet e dëshmorëve, prej marsit 2018 ka filluar t'i lëshojë vërtetimet për të refuzuarit, ndërsa tani me certifikata do të pajisen edhe veteranët pjesëtarë. Certifikatat do të shpërndahen nga komandantët e njësive, zyrat e shoqatave të dala nga lufta apo nga ZÇKL. Në javët në vijim do të përmbyllet edhe pajisja me certifikata e veteranëve pjesëmarrës", është theksuar në komunikatën e lëshuar nga Zyra për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta.



Wielandi: Mos premtoni data për liberalizimin e vizave

Zëvendësprezidenti i Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, gjatë vizitës së tij në Kosovë, i ka porositur liderët të mos bëjnë premtime sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave. Eurodeputeti gjerman ka thënë se aktualisht topi për këtë çështje është në anën e Komisionit dhe Këshillit, e jo te Parlamenti Evropian

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 10 MAJ - Zëvendësprezidenti i Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, u ka rekomanduar përfaqësuesve politikë në Kosovë të mos premtojnë datën se kur do të liberalizohen vizat dhe i ka inkurajuar të vazhdojnë të angazhohen për përmbushjen e kriterëve evropiane. Këto komente Reiner Wieland i ka bërë të enjten në Prishtinë, pas takimit me kryeministrin Ramush Haradinaj, përfaqësues të tjerë shtetërorë të Kosovës dhe përfaqësues të opozitës. "U rekomandoj të gjithëve të mos bëjnë premtime për liberaliz-

imin e vizave. Aktualisht topi është në anën e Komisionit dhe Këshillit, e jo te Parlamenti Evropian", ka thënë Wieland, eurodeputet gjerman.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova është e përkushtuar në rrugën e saj evropiane dhe të integritimeve euroatlantike. "Qytetarët tanë meritojnë të jenë të barabartë dhe të lëvizin lirshëm në vendet e BE-së. Ne po presim që sa më shpejt ta marrim lajmin e drejtë dhe të merituar për liberalizimin e vizave", ka thënë Haradinaj.

Në këtë takim kryeministri Haradinaj ka deklaruar se Kosova është gati për liberalizimin e vizave dhe pret



mbështetjen e Parlamentit Evropian në këtë proces. Më tej, Haradinaj ka theksuar edhe rëndësinë e shtimit të

bashkëpunimit ekonomik me Gjermaninë, duke i forcuar marrëdhëniet bilaterale me këtë vend. "Kosova është partnerja ideale e Gjermanisë për ta forcuar bashkëpunimin ekonomik. Ne kemi resurset e nevojshme, të përshtatshme për investitorët gjermanë dhe tani është koha të shohim projekte konkrete në këtë drejtim", ka deklaruar Haradinaj.

Ndërkaq zëvendësprezidenti i Parlamentit Evropian, Reiner Wieland, e ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për gatishmërinë e bashkëpunimit për projekte specifike nga fusha e edukimit në programet e BE-së dhe Qeverisë Gjermane, duke shprehur mbështetjen e Kosovës në rrugën e saj për fuqizimin e rendit dhe ligjit dhe përafrimin e vendit me agjendën evropiane.

Wieland ka zhvilluar një takim edhe me zyrtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). "Bashkë me kolegë nga grupi parlamentar i LDK-së pritëm në takim z. Rainer Weiland, zëvendësprezidenti i Parlamentit Evropian nga partia CDU e kancelares Merkel. E informuam për rolin që po luan LDK-ja si parti opozitare në Kuvendin e Kosovës dhe e falënderuam për rolin vendimtar të Gjermanisë dhe rolin e tij në Parlamentin Evropian në mbështetje të agjendës eurointegruese të Kosovës", ka thënë shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti. Ai ka shtuar se Weiland i ka siguruar se do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në agjendën integruese të saj, si dhe e ka përgëzuar LDK-në për rolin që po luan për ruajtjen e kursit proevropian të Kosovës.



Ekipi menaxhues për Asociacionin kërkon mbështetjen teknike nga Qeveria

MITROVICË, 10 MAJ - Anëtarët e ekipit menaxhues për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe kanë zhvilluar takimin e radhës në Mitrovicën Veriore me ministrin në dorëheqje të Administrimit të Pushtetit Lokal, Ivan Todosijeviq. Sipas një komunikate për media, në takim u diskutua edhe struktura e draft statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe elementet përmbajtjesore të dokumentit.

Anëtarët e ekipit menaxhues janë informuar edhe për nevojat teknike, kurse ministri Todosijeviq ka premtuar se do të përpiqet t'i sigurojë këtij ekipi

kushte optimale të punës, duke e ngritur këtë çështje edhe në Qeverinë e Kosovës për koordinim dhe bashkëpunim me pushtetet komunale në veri.

Ky ishte takimi i dytë i punës me ministrin Todosijeviq që nga aktivizimi i ekipit menaxhues. Aty u vendos që takime të tilla të organizohen rregullisht, në mënyrë që ta informojnë ministrin kompetent për nevojat e ekipit menaxhues dhe punën e tij. Anëtarët e ekipit menaxhues e falënderuan Todosijeviqin për mbështetjen që ata kanë nga Qeveria në Prishtinë përmes përfshirjes së ministrisë së tij dhe vetëqeverisjeve lokale nga veriu.



Sistem i ri për eksportimin e mallrave nga Kosova në Zvicër dhe Norvegji

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Dogana e Kosovës ka filluar aplikimin e sistemit "REX" në kuadër të skemës General System of Preferences (GSP) e cila u ofrohet vendeve në zhvillim, në këtë rast Kosovës nga Zvicra dhe Norvegjia. "Ky sistem u mundëson eksportuesve kosovarë që eksportojnë mallra me origjinë preferenciale në Zvicër dhe Norvegji që të regjistrohen nga Dogana e Kosovës në këtë sistem, pastaj ta kenë mundësinë për mallrat e eksportuara në këto dy vende që të lëshojnë vetëdeklaratë - faturë mbi origjinën pa pasur nevojë të pajisen me certifikatë të origjinës 'FORMA A'. Funksionimi i plotë i këtij sistemi ka filluar nga data 1 janar 2017", është thënë në njoftimin e Doganës së Kosovës. Sipas këtij njoftimi, periudha transitore nga metoda e certifikimit me certifikatën "FORMA

A" (siç ka qenë) në metodën e certifikimit përmes sistemit "REX" do të zgjasë deri më 30 qershor 2018, periudhë pas së cilës çdo eksportues që dërgon mallra me origjinë preferenciale të Kosovës në këto dy vende nuk mund të përfitojë nga preferencat e sistemit GSP pa qenë i regjistruar. "Njoftohen të gjithë prodhuesit, eksportuesit nga Kosova që eksportojnë mallra me origjinë të Kosovës në Zvicër dhe Norvegji dhe që dëshirojnë të përfitojnë nga skema e sistemit gjeneral të preferencave, ta plotësojnë formularin i cili gjendet në uebfaqen e Doganës dhe të njëjtën të vijnë ta paraqesin pranë sektorit të origjinës, në zyrat e Doganës së Kosovës në Prishtinë, në mënyrë që të regjistrohen në sistem. Pas regjistrimit do ta merrni numrin e regjistrimit të cilin duhet ta vendosin tek deklarimi fatural", është thënë në njoftimin e Doganës.



KEDS-i investon në fshatin Serbicë e Ulët të Prizrenit

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Kompania Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), në kuadër të planit zhvillimor, vazhdon të investojë edhe në Prizren. KEDS-i investimet e fundit është duke i realizuar në fshatin Serbicë e Ulët të Prizrenit, duke investuar në infrastrukturë të re elektrike. Në kuadër të projektit në fshatin Serbicë e Ulët të Prizrenit është bërë rikonstruimi i rrjetit të tensionit të ulët dhe kyçjeve shtëpiake, si dhe është vendosur një transformator i ri. Në këtë fshat janë vendosur mbi 100 shtylla të reja si

dhe kablllo bistek, nga të cilat kanë përfituar 88 familje. Zëdhënësi i KEDS-it, Viktor Buzhala, ka thënë se kjo kompani është duke punuar për rritjen e kualitetit të jetës së njerëzve përmes projekteve, ku deri tash 500 projekte janë implementuar. "Ne jemi të lumtur që përmes investimeve po arrijmë t'ua rrisim kualitetin e jetës njerëzve. Rast i njëjtë është edhe ky në Serbicë të Prizrenit. Deri tash kemi përfunduar 500 projekte. Ky është tregues që KEDS-i është krah konsumatorëve dhe qytetarëve, pra është një vlerë e shtuar e vendit", ka thënë

Buzhala.

Ndërsa banorët e fshatit Serbicë e Ulët shprejnë se pas ndërrimit të rrjetit elektrik do të përmirësohet furnizimi me energji elektrike.

Rexhep Gashi, banor i fshatit, ka thënë se gjendja me energji elektrike në këtë fshat ka qenë shumë e keqe. Ai ka thënë se me këtë investim shprejnë se gjendja do të përmirësohet. Plani Zhvillimor i Rrjetit të Shpërndarjes është një master plan i KEDS-it që parasheh investimin e 300 milionë eurove në rrjetin distributiv elektrik të Kosovës deri në vitin 2025.



Për katër muaj mbi 700 shkyçje në ujësjellës

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina" ka njoftuar se prej 25 janarit të këtij viti, kur ka nisur shkyçjen e borxhlinjve, ka arritur t'i shkyçë nga rrjeti 700 konsumatorë. "Brenda katër muajve janë realizuar mbi 700 shkyçje nga sistemi i rrjetit të ujësjellësit, janë vizituar mbi 3 000 konsumatorë borxhlinj dhe janë dërguar te përmbaruesit privatë rreth 1 200 lëndë të konsumatorëve që nuk janë të rregullt ndaj shërbimeve të ujësjellësit. Veç në muajin prill 2018 janë shkyçur 170 kon-

sumatorë", është thënë në njoftimin e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina".

Në shkyçje janë të përfshira tetë komunat në të cilat operon KRU "Prishtina", si: Prishtina, Fushë-Kosova, Obiliqi, Podujeva, Shtimja, Drenasi, Lipjani dhe Graçanica, me fshatra përreth. Aksioni do të vazhdojë deri në fund të këtij viti.

Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina" ka njoftuar se ky aksion do të vazhdojë. Sipas kësaj kompanie, borxhi i konsumatorëve është mbi 50 milionë euro.

2.3 milionë dollarë ndihmë për përmirësimin e mjedisit të biznesit



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka nënshkruar të enjten marrëveshje me IFC-në dhe qeverinë zvicerane në vlerë prej 2.3 milionë dollarësh për ndihmë për përmirësimin e mjedisit të biznesit përmes reformimit të sistemit të inspektimeve të biznesit dhe duke thjeshtëzuar procedurat administrative

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 MAJ - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka thënë se kjo ndihmë është shumë e rëndësishme sepse do t'i shërbejë Kosovës për përmirësimin e mjedisit biznesor. "Për ne është shumë e rëndësishme kjo marrëveshje, sepse prek disa fusha që MTI-ja i ka prioritet, në veçanti fushën e të bërit biznes, që MTI-ja

është udhëheqëse e taks forcës. Fushë tjetër është edhe tërheqja e investimeve të huaja, që tashmë është jetësuar Ligji për Investime Strategjike dhe jemi në proces të hartimit të një strategjie sa iu përket investimeve direkte", ka thënë Hasani.

Ministri ka theksuar se ndihma e IFC-së dhe Qeverisë Zvicerane do të ndikojë për reformimin e inspektimeve të biznesit. "Pjesë tjetër e këtij

projekti janë edhe reformat inspektuese, sepse ne kemi kaluar koncept dokumentin që mendohet të bëhet një reformim komplet i inspektoratit, për arsye se sot në nivel të vendit kemi 42 inspektorate ku mendohet të reduktohen në 15 sosh", ka thënë ministri Hasani. Sipas tij, 2.3 milionë dollarë do të shërbejnë që Kosova t'i fitojë përvojat e vendeve të Bashkimit Evropian dhe të vazhdojnë reformat.

"Besoj se nga kjo ndihmë që po i jepet Kosovës do t'i kem përvojat më të mira si ato të Bashkimit Evropian dhe do të shërbejnë për koordinim të plotë në mes të inspektorateve lokale dhe qendrore. Vlen të theksohet se kjo ndihmë në vlerë prej 2.3 milionë dollarësh është kredi pa kthim dhe për këtë dua ta falënderoj shumë qeverinë zvicerane që po na ndihmon në politikat tona që t'i shtyjme proceset përpara dhe të krijojmë një vend atraktiv për investitorët e huaj", ka thënë Hasani.

Ndërsa Thomas Lubeck, menaxher rajonal i IFC-së për Evropën Qendrore dhe Juglindore, ka thënë se synimi i tyre është përmirësimi i klimës së

investimeve në Kosovë. "Ne do të punojmë me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për reformën rregullatore, duke ndihmuar në rritjen e transparencës dhe tërheqjes së investimeve në Kosovë për ta nxitur rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës", ka thënë Lubeck.

Qeveria zvicerane ka kontribuar me 2.3 milionë dollarë amerikanë në projektin më të gjerë të klimës së investimeve që do të zbatohet deri në vitin 2020. Projekti është në përputhje me Objektivat e Strategjisë së Bashkëpunimit Zviceran për Kosovën 2017-2020 për krijimin e një mjedisi të përshatshëm për bizneset dhe për t'i rritur investimet.

Bie çmimi i prodhimeve blegtorale

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 MAJ - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi" për tremujorin e parë (TM1 2018) (2015=100).

Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Sipas ASK-së, grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe në vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen. Kjo agjenci ka bërë me dije se në këtë tremujor ka pasur rënie të prodhimeve blegtorale. "Prodhimet, të cilat krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore, janë ndarë në dy grupe kryesore: prodhimet bimore dhe ato



blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore çmimet janë grumbulluar për këto grupe:

drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë

grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet

grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë. Në tremujorin e parë të vitit 2018 indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rënie për - 1.27 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Kurse indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rënie për - 3.72 për qind", është thënë në njoftimin e ASK-së.

Ndërsa indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rënie për -1.81 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017.

ASGJË NUK ËSHTË TRESHI APO DHJETËSHI KRAHASUAR ME KAQUSHËN DYMBËDHJETËTYTËSHE!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

O ku je Rrahman Morina hej: Të ikurit e LV-së më në fund e formuan, trashëguan subjektin politik i cili, përjashtuar disa raste, është partia e prindërve të tyre që bënë shtatë palë qejfe në kohën e kriminelit Tito dhe "humanistit" Millosheviq. Në fakt, subjektin politik e morën në formë të stafetës si në kohën e kriminelit Tito ku, Kaqusha Jashari ua dorëzoi partinë klinikisht dhe politikisht të vdekur, por që e ka një emër, Partia Socialdemokrate e Kosovës. Kjo përngjanë me një gurë mbi varr ku është emri i të varrosurit dhe disa informata të tjera, për të vdekurin. Kaqusha, një emër tipik rus e që për bazë e ka granatahedhësin shumë-tytësh, u bë i popullarizuar pas Luftës së Dytë Botërore edhe në Shqipëri, sidomos në ish-Jugosllavi, për shkak të rolit të ish-BRSS-së për çlirimin e ish-Jugosllavisë. Realisht, të ikurit nga LV-ja, deklarimin se janë për bashkim kombëtar dhe patriotë, e kishin fals me përjashtim të 3-4 vetave që kishin një përmbajtje kombëtare sikur që edhe luftuan në radhët e UÇK-së. Pas shkrirjes së disa ish-trashëgimtarëve të politikës jugosllave dhe serbe në PSDK e Kaqusha Jasharit, skena politike në Kosovë po "fisnikërohet" me një politikë nga e kaluara, por që është shumë e popullarizuar sot. Sa më shumë që ta shani luftën e UÇK-së dhe bartësit e kësaj lufte, aq më mirë do të sistemoheni në institucionet e Kosovës duke fituar poste me respekt dhe me shumë të mira materiale. Kjo kategori i ka dyert e hapura dhe ka përparësi absolute gjatë punësimit dhe thuaja asnjëri nga ta nuk punon me rroga të buxhetit të Kosovës. Këta horra të dikurshëm e patriotë të sotëm, ose janë këshilltarë, ose ministra e më së paku bëhen ambasadorë. Realisht, nuk mund ta keni një post sot në Kosovë apo në diplomaci dhe ta keni përkrashjen e ndërkom-bëtarëve nëse nuk e keni një të kaluar jugosllave apo të mendësisë serbe, të jeni apo të

keni qenë anëtar i UDB-së apo KOS-it, ju apo familjarët, kurse këta terakët që vetëm fiktivisht kanë pushtet në Kosovë, në fakt janë vegla të mbeturinave jugosllave dhe serbe. Në kohën e ilegales sistemi i treshes ishte mënyra më e mirë e të vepruarit dhe këtë sistem e morën edhe një pjesë e LV-së gjatë orgjive seksuale, pas aksioneve "politike", duke e rrahur Policinë e Kosovës. Më duket se edhe Rexha i LV-së, gjatë ilegales apo luftës njihej si dhjetëshi, mirëpo Kaqusha Jashari ua kaloi dy modeleve, duke e instaluar sistemin e 12-të, duke fituar 12 deputetë me një parti, kufomë të balsamosur në kriptat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Të ikurit e LV-së e gjetën mënyrën më të mirë që me një procedurë të përshpejtuar ta legalizojnë organizimin politik duke i premtuar Kaqushës, Bajramit, se do të bëhen deputetë në zgjedhjet e ardhshme për të cilat jam shumë i sigurt se, nëse mbahen në afatin 12 muajsh, do ta kalojnë prapë zgjedhor sikur dikur FER-i! Tradita mund të përsëritet sepse, përjashtuar disa persona që nuk ishin në FER, pjesa dërrmuese ishin FER-istë sikur që edhe figura qendrore e FER-it të dikurshëm ishte edhe Zog Ahmeti, tash mbret i fronit politik të Kaqushës e që është garantues i dështimit të sigurt. Këta që fituan postin e deputetit e që hynë nën "urdhër" të Kaqushës, dezertorët, ia panë hairin LV-së dhe Albin Kurtit. Përveç se i bëri deputetë, nga dështakët si çifti i Zogut me shokë, i bëri edhe kryetarë komunash, ndër-sa krahun kriminal e bëri "klub të milionerëve" që bënë pasuri përralore me leje ndërtimi dhe kurvëri politike, me biznesmenët e kriminalizuar. Tash Albin Kurti nuk ka asnjë të drejtë t'i kritikojë të arratisurit sepse vetë ai i bëri me poste, pa e konsultuar fare partinë. Nuk është sot Albini në pozitën e Homeinit që lëshoi Fatvën kundër shkrimtarit Salman Ruzhdi e që u detyrua të fshihet dhe pjesën dërrmuese të jetës e kaloi në ilegalitet. Këta po e sfidojnë Albinin nga qendra e Prishtinës të cilën e ka masakruar kryetari i Kaqushës, në një hotel me shumë yje dhe i cili ofron shërbime për të gjitha ata që kanë mundësi të paguajnë. Nuk ka me rëndësi se ku e kanë mbajtur Kuvendin e jashtëzakonshëm sepse këta që u shkrinë në zemrën politike të

Kaqushës kanë para ta mbajnë Kuvendin edhe në hotelin Burjab El Arabi në Dubai (hotel me 7 yje) dhe për këtë merita të mëdha ka vetë Albini sepse ua mundësoi ta sigurojnë "me punë të ndershme" këtë mirëqenie socialdemokrate krejtësisht modeste prej të qenit milionerë të varfër. Pastaj, anëtar i PSD-së u bë edhe "Dimitrie Tucoviqi" nga Amerika, mbase për ta fituar ndonjë tender socialdemokrat në Prishtinë sikur që është ndërtimi i institucioneve në Hajvali e që është më se e nevojshme për Hashimin, me shokë pak. Ku keni parë shtet e që nuk ka rezidenca, salla argëtimi, dhoma për ngacmime, pishina, terren për tenis dhe fushë ku praktikohet sporti tradicional shqiptar dhe kosovar, loja me guxha për çka presidenti është mjeshtër dhe doajen. Po këta patriotë të socialdemokracisë e morën vulën kombëtare duke u pajisur me pasaporta të Shqipërisë dhe duke u bërë (disa prej tyre) pronarë të tri pasaportave; të Kosovës ku janë vetëm rezidentë, të Serbisë dhe Shqipërisë ku janë shtetas. Në këtë drejtim Albini nuk është pa mëkate dhe tani po i paguan faturat duke e bërë LV-në me politikanë të skaduar mandati apo LPK-istë të konvertuar. Kaqusha fitoi 12 deputetë në kohën kur asnjëherë nuk e kaloi prapë zgjedhor. Kur ishim të burgosur në llogorin Stara Gradishka të Kroacisë, në Kosovë zhvilloheshin ngjarje dramatike; minatorët u ngjjuan në zgafelle, kurse protestuesit marshonin drejt Prishtinës duke kënduar: "nëpër borë dhe nëpër shi, oj Kaqushë oj bukuri..." e që nënkuptonte përkrashjen për të. Atëherë, ne të burgosurit politikë shqiptarë që e identifikonim Azemin si njeriun më të urryer në Kosovë i cili ishte në gjendje që flamurit kombëtar t'i vendosë edhe kokardën e Drazh Mihajlit vetëm për ta fituar simpatinë dhe bekimin e Millosheviqit, në mungesë të alternativës dhe mungesë të liderëve të guximshëm, menduam se Kaqusha do ta bënte dallimin nga e kaluara duke i prirë lëvizjes masive shqiptare. Azemi nuk kishte qojë të bëhej lider e as që kishte përmbajtje për këtë rol. Sa po e admiroj Kaqushën për vizionin politik dhe alkiminë e kthimit të një kohe të perënduar përmes riciklimit të politikanëve të dikurshëm në trajtën e

trashëgimtarëve biologjikë në PSDK, po ndiej keqardhje që në mesin tonë nuk janë Rrahman Morina, Kolë Shiroka dhe Sinan Hasani sepse, me pak përforsime si puna e Azemit me ca shokë, me një pjesë të krahut të luftës që po i nënshtrohen çdo situatë dhe që ndiejnë respekt dhe nder t'u shërbejnë të lartpërmendurëve, partia e tyre, nëse i kemi parasysh edhe rrethanat vendore dhe ndërkombëtare, pa asnjë dyshim do të bëhej grupi më i madh parlamentar në Kuvendin e Kosovës. Atëherë askush nuk do të merrej më me Kaqushën dhe formacioni e ri politik të PSDK-së i cili do të llogaritej si pakicë parlamentare.

Merkeli, si tregues i forcës politike në Ballkan: Në fillim gruaja më e fuqishme në botë dhe më e fuqishme se thuaja të gjithë politikanët meshkuj në botë, kancelarja Angela Merkel, kishte simpati dhe bënte përpjekje ta promovojë Edi Ramën si politikanin numër një në Ballkan, duke e lënë në hije Vuçiqin e Serbisë kurse Thaçin, as që e kishte në listën e pritjes. Më vonë Ramës iu ngatërruan punët në Shqipëri sepse nuk ishte në gjendje ta mbikëqyrë rritjen e "barit" i cili përhapej edhe në vendet fqinje, Itali në rend të parë. Ramës i nxori shumë problem edhe "gjyshi i Lazaratit", i cili ishte në pushtet në Shqipëri thuaja 27 vjet sikur edhe "nipi" i tij i cili, sa ishte ministër, Rugën e Kombit e shndërroi në një trajektore të një qyteze, pa treguar se ku shkuan lekët për autoudhën që kurrë, së paku deri më tani, nuk u bë autoudhë sipas standardëve ndërkombëtare e që mrekullisht shpëtoi nga burgu falë fuqisë politike dhe pozitës që e kishte sponsori i tij politik, "gjyshi i Lazaratit". Tash këta kusarë të Rugës së Kombit, rrobat e palara duan t'ua veshin të tjerëve duke ua vënë flakën pikave ku duhet të paguhet taksa për shfrytëzim të autoudhës dhe e cila është në s'përputhje me mundësitë që i kanë shqiptarët. Pastaj, Edi Rama shkoi në takim me atlete të bardha sikur të ishte ftuar si i ftuar special në Rugën e Trëndafilave në Amsterdam. Rrjedhimisht, sa binte potencia politike e Ramës, me ndihmën e viagrës ruse ala Putin, rritej potencia politike dhe besimi i kancelares Merkel te trashëgimtari politik i Millosheviqit dhe Sheshelit, te

Aleksandar Vuçiq. Kancelarja Merkel së fundi priti tre presidentët e shteteve ballkanike që ende kanë probleme të pazgjidhura dhe që mund ta rrezikojnë sigurinë e rajonit: Vuçiqin, Ramën dhe Thaçin. Kjo ishte renditja e pritjes dhe pikërisht renditja tregon fuqinë politike dhe rëndësinë që e kanë te zonja Merkel. Natyrisht se Vuçiqi mori disa detyra e që janë shumë më të lehta se ato të Thaçit, kurse nga Rama u kërkua të ketë rol neutral midis Vuçiqit dhe Thaçit apo, në rast se kërkohet nga ai, të bëjë presion pozitiv që Thaçi t'i bëjë lëshimet e duhura që e forcojnë sovranitetin e Kosovës, me ndihmën e komunave serbe në Kosovë. Vuçiqi dhe Rama me këtë vizitë e forcuan pozitën politike brenda vendeve të veta, kurse presidenti Thaçi e shfrytëzoi vizitën zyrtare për ta shpërndarë librin: "Shteti i ri, lideri i ri - Autobiografia" e që, për të painformuarit, më duhet të them se aktualisht janë dy libra që po e tronditin botën me përmbajtjen e tyre, i pari: "Zjarr dhe tërbim" kushtuar Donald Trampit dhe e dyta autobiografia e Hashim Thaçit. Mund të më llogarisni si të marrë dhe të painformuar por, ju lutem, para këtij konstatimi, lexoni pak më shumë dhe do të bindeni edhe vetë. E keni parë ku e bënë promovimin e librit presidenti Thaçi dhe kush merr pjesë në këto promovime ku Shkëlqesia e Tij, Presidenti Thaçi, me fjalët më të zgjedhura dhe më të mençura nënkështuan librat që shkojnë si bakllavaja e Sulltan Taipit. Dhe kush e mban fjalën e rastit. Nuk është e njëjtë sikur kur Mirsadi dhe Besiani shesin libra në Sheshin "Nëna Tereza", sikur kur Thaçi shpërndanë libra në prani të Makronit dhe kancelares Merkel. Vetëm një gjë më vjen keq kur e shoh presidentin tonë të shkëlqyer dhe shumë të dashur kur shpërndanë libra kur aty ka sherpas sakrifikes, njëri di shkrim-lexim, kurse tjetri është hamall i përjetshëm! Asociacioni, si bisht i Demarkacionit: Me faqe të bardhë e votuam Demarkacionin e kufirit me Malin e Zi. Nga 120 deputetë sa ka Kuvendi i Kosovës, për Demarkacionin votuan 128 deputetë. Tash ka mbetur vetëm Asociacioni. Albini po thotë se Asociacionin Qeveria do ta sjellë pabesisht në Kuvend në muajin gusht, kur temperaturat janë të larta dhe

deputetët janë në pushime (nga lodhja e madhe për punën që e bëjnë në mënyrë fakultative, me honorarë fantastikë). Nga aspekti i ligjeve të fizikës, Albini ka të drejtë sepse në temperatura të larta çdo gjë zgjerohet, kurse në temperatura të ulëta çdo gjë tkurret. Interpretimi shkencor thotë se në muajin gusht, për shkak të temperaturave të larta, rriten topet që rinë të varura (jofunksionale) dhe zgjerohet prapanica që janë parakushtet kryesore që Asociacioni të kalojë pa probleme. Unë e kundërshtoj këtë interpretim shkencor të fizikës sepse kur u votua Demarkacioni, temperaturat ishin të ulëta, prapanica do të duhej të ishte e rrudhur, mirëpo ndodhi e kundërta, u zgjerua më shumë sesa që duhej, madje edhe tek ata që mburreshin me muskujt e kësaj pjese të trupit që është përcaktuese për marrjen e vendimeve të mëdha për dallim nga platformat e deritashme të partive politike. Albini duhet ta ketë të qartë se Asociacioni nuk është përgjegjësi e Kuvendit e as që do të votohet në Kuvend, por se formohet me një vendim të Qeverisë apo, sipas Thaçit, ky Asociacion do të regjistrohet në Departamentin e MAP-it për regjistrim të OJQ-ve të reja. Unë i besoj Thaçit, jo nga frika, por se nuk ka ndodhur kurrë që Thaçi të thotë diçka e të bëhet ashtu siç thotë. Pastaj, kjo Gjykatë Kushtetuese, gjysmë analfabete siç është, nëse ka urdhër politik, edhe macen do ta bëjë qen në interpretimin e saj dhe do të ketë plotësisht të drejtë sepse, edhe macja, edhe qeni janë të së njëjtës familje. Ma sqaroni, ju lutem, si injorant që jam, ta kuptoj interpretimin se: "marrëveshja për formimin e Asociacionit e arritur në Bruksel, përbën 23 shkelle të Kushtetutës së Kosovës, por se mund të vazhdohet me formimin e Asociacionit ...". Është mëkat se këtë vit nuk do të ndahet Çmimi Nobel për Letërsi apo se nuk ekziston Çmimi Nobel për Budallaki sepse, me këtë formulim gjuhësor dhe me këtë formulim superdiotesk, Çmimi Nobel për të parin formulim apo për të dyja bashkë nuk do të kishte konkurrencë, do ta fitonte Gjykata Kushtetuese e cila, moralisht do të detyrohej të ndante një pjesë të këtij çmimi për shkruesin e këtij interpretimi e që është dikush nga "miqtë ndërkombëtarë". Ne nuk kemi kapacitet të shkruajmë kesi interpretimi biseksual juridik, por jemi të pakonkurrencë ta luajmë rolin e budalait. Për një grusht parash! Lexues të nderuar, në shkrimin tim e kam bërë një gabim të qëllimshëm, gjejeni!

Gjakova lanson platformën për gjobat mandatore

GJAKOVË, 10 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, së bashku me Drejtorinë e Inspeksionit dhe me komandantin e policës ka mbajtur të enjten mbledhje me 19 zyrtarët e caktuar për shqiptimin e gjobave mandatore dhe kanë lansuar platformë për shqiptimin e tyre. "Do të provojmë që qytetin e Gjakovës ta shohim si qytetin më të pastër të Kosovës. Unë bashkë me ju dhe me të gjithë qytetarët e ndërgjegjshëm do ta bëjmë Gjakovën më të pastër. Bindjet e mia të thella janë se, nëse ndonjëherë dikush ju flet për patriotizëm, për komb, për shtet dhe hedh një kanaçe për dritare të automjetit, mos i besoni. Minimumi i minimumit që dikush mund të veprojë për vendin e vet është të paktën ta mbajë të pastër", është



shprehur Gjini. Gjatë këtij takimi u bë me dije se Ligi për shqiptimin e gjobave do të funksionojë përmes përmbaruesit privat, i cili mjetet e personave të gjobitur do t'i tërheqë në afat brenda 15 ditësh. "Në shqiptimin e këtyre gjobave do të jetë

edhe asistenca e pamunguar e Policisë së Kosovës", ka thënë komandanti i Stacionit Policor në Gjakovë, Krist Gjoka. 19 zyrtarët komunalë do të jenë në aksion të përditshëm për shqiptimin e këtyre gjobave, kostoja e të cilave është e përcaktuar me ligj.

Hidhet drogë brenda qendrës korrektuese në Lipjan

LIPJAN, 10 MAJ - Disa persona të panjohur nga një veturë me targa vendore kanë hedhur narkotikë brenda Qendrës Korrektuese në Lipjan. Rasti ka ndodhur të mërkurën pas orës 17:00, thuhet në njoftimin e Policisë. "Raportohet se persona të dyshuar, të panjohur, nga një veturë me targa vendore, kanë hedhur brenda rrethojës së qendrës korrektuese disa qese të dyshuar me substanca narkotike të llojit marijuanë. Njësia përkatëse policore ka bërë konfiskimin e substancave narkotike dhe është duke e hetuar rastin", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.



Banorët e Zhabarit kërkojnë ndihmë nga komuna për problemet në infrastrukturë



MITROVICË, 10 MAJ (ER) - Një grup qytetarësh nga Zhabari i Komunës së Mitrovicës janë pritur të enjten në një takim nga nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, të cilin e kanë informuar

për disa probleme me të cilat ata po ballafaqohen në lagjet ku jetojnë. Përfaqësuesi i qytetarëve, Feriz Ferizi, i ka thënë nënkryetarit Mujka se ka disa dekada që ata ballafaqohen me

problemin e kanalizimit dhe të një kanali që shërben për bartjen e tepricës së ujit të kanalit Ibër Lepenc, por që pas lufte ky problem është thelluar. Ferizi ka pohuar se nga kanali i

lartpërmendur, në të cilin derdhen edhe kanalizimet e shumta të shtëpive, vazhdimisht dalin ujërat, kryesisht ato të kanalizimeve dhe i vërshojnë rrugët, kopshtet dhe pronat e tjera të cilat dëmtohen tej mase. "Në pjesën ku jetojmë rreth 100 familje, jeta na është vështirësuar nga uji dhe kanalizimet. Rrugët janë të mbyllura dhe vetëm me çizme mund të kalohet nëpër to. Po ashtu, kopshtet dëmtohen tërësisht ngaqë vazhdimisht janë nën ujë, gjithashtu edhe pronat e tjera. Ne po kërkojmë ndihmën tuaj që t'i tejkalojmë më në fund këto telashe shumë të mëdha për ne", ka thënë përfaqësuesi i qytetarëve të Zhabrit, Feiz Ferizi. Nënkryetari Mujka ka thënë se komuna do të bëjë gjithçka që është e mundur që problemet të zgjidhen.

Vazhdon dezinfektimi i zonave endemike në Komunën e Malishevës

MALISHEVË, 10 MAJ (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) është duke e financuar projektin "Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për ethe hemoragjike krime-kongo në fshatrat e Komunës së Malishevës", i cili projekt ka për qëllim luftimin e shkaktarit të sëmundjes krime-kongo të shkaktuara nga rriqrat, krye-

sisht në Komunën e Malishevës. Për implementimin e këtij projekti MBPZhR-ja ka siguruar shumën prej 819 mijë eurosh për periudhën e cila do të zgjasë 36 muaj dhe do të realizohet nga kompania N. Sh. H. "Zona Park", e përzgjedhur përmes Divizionit të Prokurimit në MBPZhR si dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

[illegible]

Macroni kërkon uljen e tensionit mes Izraelit dhe Iranit

PARIS, 10 MAJ - Presidenti francez Emmanuel Macron bëri thirrje për uljen e tensioneve mes Izraelit dhe Iranit, që janë përfshirë menjëherë në një përdorim të dhunës mes dy vendeve në Siri,

njoftoi të enjten Presidenca franceze. "Ai bëri thirrje për ulje të tensioneve dhe do të bisedojë për këtë çështje me kancelaren gjermane Angela Merkel", njoftoi Pallati Elize.

Macroni do të takohet të enjten me Merkelin në Aix-la-Chapelle, Gjermani, me rastin e dhënies së një çmimi evropian. Ushtria izraelite ka bombarduar gati të gjitha infrastrukturën iraniane në

Siri si kundërpërgjigje ndaj sulmeve me raketa, dje në mbremje, ndaj pozicioneve të saj në Golan, që mendohet se janë zhvilluar nga forcat iraniane që ndodhen në Siri.



Trumpi dhe Kim Jongu takohen më 12 qershor

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, duke njoftuar se takimi me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, do të mbahet më 12 qershor në Singapor, tha se ShBA-ja po i fillon marrëdhëniet me Phenianin nga një bazë e re



UASHINGTON, 10 MAJ - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, njoftoi se takimi me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, do të mbahet më 12 qershor në Singapor. Njoftimi vjen pasi Trumpi priti personalisht tre amerikanë të liruar që u kthyen të enjten në mëngjes nga Koreja e Veriut. Ai deklaroi se Shtetet e Bashkuara po i fillojnë marrëdhëniet me Phenianin nga një bazë e re.

Presidenti Donald Trump, nën-presidenti Mike Pence dhe gratë e tyre ishin mes atyre që dolën për t'i përshëndetur tre amerikanët e liruar nga parburgimi në Korenë e Veriut, të cilët arritën të enjten herët në bazën Andrews pranë Uashingtonit.

Të tre amerikanët e liruar dolën nga avioni me dy gishtat lart në shenjë fitoreje.

Pak çaste më vonë, presidenti Trump tha se lirimi i tyre në këtë kohë erdhi disi papritur. "Ne e

vlerësojmë shumë që ai i lejoi ata të ktheheshin përpara takimit. Kuptohet se ne do të kishim qenë në gjendje t'i merrnim këta tre njerëz të mrekullueshëm edhe gjatë takimit dhe t'i sillnim në shtëpi, por ai pati mirësinë t'i lironte përpara takimit. Sinjerisht nuk kishim menduar se kjo do të ndodhte, por ndodhi", tha ai.

Ndërkaq presidenti Trump njoftoi se takimi me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, do të mbahet më 12 qershor në Singapor.

Koreano-amerikanët u liruan pasi sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, shkoi në Korenë e Veriut për herë të dytë brenda një muaji për t'u takuar me udhëheqësin koreanoverior.

Tony Kim dhe Kim Hak Song jepnin mësim në Universitetin e Phenianit për Shkencën dhe Teknologjinë, kur u arrestuan në vitin 2017, të akuzuar për pjesëmarrje në aktivitetet

antiveqeritare.

I burgosuri i tretë, Kim Dong Chul, u arrestua në tetor 2015 dhe u dënua me 10 vjet burgim me punë të rëndë pasi u shpall fajtor për spiunazh. "Na trajtonin në mënyra të ndryshme. Unë bëja shumë punë të rënda, por kur u sëmura ata më kuruan", tha ai.

Ish të burgosurit u dërguan menjëherë në një institucion mjekësor

ushtarak për t'u takuar me familjen para se t'u bëhej ekzaminimi i gjendjes fizike. Para largimit nga baza ajrore, presidenti Trump vlerësoi përpjekjet e sekretarit të shtetit Mike Pompeo. Trumpi thotë se qëllimi është që Koreja e Veriut të pajtohet për çnuklearizimin.

Megjithatë, ekspertët thonë se të dyja palët janë shumë larg në

qëndrimet e tyre. "Kemi një rrugë të gjatë në përpjekjen për ta kthyer këtë hap diplomatik me Veriun në diçka afatgjatë. Kjo mund të jetë një paqe e qëndrueshme dhe mund të çojë në çarmatimin bërthamor", thotë eksperti Patrick Cronin. Ekspertët paralajmërojnë se puna e vështirë e negociatave diplomatike sapo ka filluar.

Rusia dhe Gjermania, thirrje për ruajtjen e paktit bërthamor

MOSKË, 10 MAJ - Ministrat e jashtëm të Rusisë dhe Gjermanisë thonë se janë duke punuar për të shpëtuar marrëveshjen bërthamore me Iranin, pasi presidenti amerikan, Donald Trump u tërhoq nga kjo marrëveshje dhe tha se do të rivendosë sanksione ndaj Teheranit.

Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, duke folur në Moskë pas takimit me homologun gjerman Heiko Maas, tha se është e rëndësishme që sanksionet e reja amerikane të mos shkatërrojnë marrëveshjen e vitit 2015 në mes të Teheranit dhe fuqive botërore. "Pa asnjë dyshim, ne do të sigurohemi se kjo nuk do ta shkatërrojë mar-



rëveshjen. Ky është objektivi ynë i përbashkët", tha Lavrov në konferencën e përbashkët për media me homologun e tij gjerman. Marrëveshja bërthamore i mundëson Teheranit lehtësim të sanksioneve në këmbim të frenimit të programit bërthamor. Lavrov shtoi se Rusia, Gjermania, Kina, Britania dhe Franca - shtetet nënshkruese të

marrëveshjes me Iranin - duhet të punojnë për ta "mundësuar ruajtjen e këtij dokumenti të rëndësishëm për stabilitetin rajonal".

Ndërkaq, kryediplomati gjerman, Maas tha se është e rëndësishme që Irani t'iu përmbahet obligimeve që dalin nga marrëveshja, pavarësisht vendimit të Trumpit për të vendosur sanksione të reja mbi Teheranin, duke bërë thirrje që Rusia të përdorë ndikimin e saj ndaj Iranit, që ky i fundit të respektojë marrëveshjen. "Është e rëndësishme që Irani të qëndrojë në marrëveshje. Është në interesin e Iranit po ashtu, që kjo marrëveshje të vazhdojë", tha Maas.

Erdogani zotohet se do t'i ruajë marrëdhëniet ekonomike me Iranin

ANKARA, 10 MAJ - Turqia do t'i ruajë dhe do t'i përmirësojë marrëdhëniet tregtare me Iranin, tha presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan gjatë takimit me homologun e tij në Teheran, Hassan Rohani. Këto komente të Erdoganit vijnë disa ditë pasi Shtetet e Bashkuara vendosën të largohen nga marrëveshja bërthamore me Iranin dhe u zotuan se do të vendosin sanksione ndaj Republikës Islamike.

Erdogani i tha presidentit Rohani se vendimi i Uashingtonit, që njëanshëm të largohet nga mar-



rëveshja, ishte gabim dhe u zotua se do të punojë për t'i forcuar marrëdhëniet dypalëshe, raporton agjencia shtetërore e lajmeve turke, Anadolu.

Irani është furnizuesi i tretë më i madh i Turqisë me naftë dhe burimi i dytë më i madh i gazit natyror. Tregtia mes dy shteteve është rritur në vitet e fundit.

Parlamenti i Hungarisë zgjedh Orbanin në postin e kryeministrit

BUDAPEST, 10 MAJ - Parlamenti i Hungarisë ka rizgjedhur Viktor Orbanin në postin e kryeministrit. Ky është mandati i tretë radhazi i

Orbanit në këtë post dhe i katërti në përgjithësi. "Ne kemi zëvendësuar një demokraci liberale me një demokraci të krishterë të


shekullit 21, e cila garanton lirinë e njerëzve dhe sigurinë", u shpreh Orban para Parlamentit hungarez. Partia e Orbanit, Fidez, fitoi

zgjedhjet parlamentare të mbajtura muajin e kaluar. Fushata e tij u dominua nga politikën kundër migrantëve.



Nga shkolla kombëtare e Prekazit për progres kombëtar deri në liri (1)

Vlera historike dhe filozofike-kombëtare e luftës së UÇK-së 1991-1999 nuk guxon të nëpërkëmbet



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

1. UÇK-ja paralajmëroi epokën e neoluftës, por jo të sotmen faktike që shqetëson

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare në Kosovë gjatë viteve 1991-1999, gjithnjë e më tepër në shumë vende në një "qetësi" marramendëse politike, po merr përmasa të gjëra në lëmin e hulumtimit në shkencat e historisë, filozofisë, politologjisë, sociologjisë, diplomacisë, gjeostrategjisë, etnopsikologjisë dhe të organizmit në përgjithësi. Në më se 99 % po hulumtohen synimet e reja gjeostrategjike, pa e treguar adresën dhe qëllimin. Me fjalë të tjera, lufta e UÇK-së po bëhet që të mbetet anonim hulumtimi, prandaj në qendrat e superfuqive është ngritur i tërë ky "alarm" për të përfituar, madje duke krijuar edhe Gjykatë Speciale, "post mortem" Tribunalit të Hagës, vetëm për Kosovën (shqiptarët që luftuan për liri), thua se këtu, në këtë luftë shqiptarët kanë bërë "krime më ogurzeza", nga vrasjet individuale e deri te ato kolektive dhe duke zbuluar edhe "trafikim" të organeve njerëzore, operacionet e të cilave "janë bërë" në stalla të bagëtive. Larg, fare larg ka shkuar filozofia për t'i mbuluar këmbët e interesimit të kësaj shkolle mesquine që me çdo kusht lufton që popujt e robëruar mos ta përdorin si model. Në këtë luftë, nuk ka mbetur Zonë Operative e Kosovës, e që nuk janë akuzuar komandantët. Dhe, në rrafshin e hulumtimi të ardhmërisë, që mos të prodhohen lufta të tilla çlirimtare po luftohen nga çdo pozicion, në mendimin strukturor dhe eksplikative logjike, sepse lufta e UÇK-së e ka ndarë historinë e luftërave në përgjithësi, deshi dikush ose jo, në dy pjesë-etapa. Po, po, ka shtete sot që i kanë përbrenda nja 20 Kosova, madje me nga 5 deri në 15 milionë banorë kombëtarisht të veçantë. Këtu është madhështia e UÇK-së dhe e

luftës saj të drejtë që në tërë globin do të mbetet si model. E vërteta, jo që e ka ndihmuar, por që iu ka bashkangjitur kësaj lufte të lavdishme, NATO-ja, me implikimin në këtë luftë e ka nderuar UÇK-në por mos të harrojmë se edhe veti ia ka rritur famën dhe siguruar ardhmërinë.

Jo vetëm për shkak të fundit të luftës së UÇK-së, por shumë më tepër për shkak të fillimit, për shkak të mënyrës së komandimit, në fund të shekullit XX u zbuluan doktrina të reja ushtarake, gjithnjë lidhur me konceptin përfundimtar të një kundërhënie që në histori është e vjetër, pothuajse është e vjetër sa edhe njeriu. Lufta e UÇK-së i zbuloi limitet e historisë së luftërave. Së këndejmi, deri më 1998 çdo luftë që është zhvilluar në rruzullin tokësor mund të strukturohet në paleoluftë (luftë e vjetruar). Ndërsa, lufta që u zhvillua në Kosovë deri më 10 qershor 1999, mund të sistemohej si fillim i një gjeostrategjie të re, që në shkencën e historisë do të quhet me emrin neoluftë.

Në paleoluftë, qëllimi ishte që vrasat në mes palëve kundërshtarë të jenë sa ma të mëdha, por fundi të shpalojë jo vetëm triumfalizëm politik, por edhe njëfarë miti "religjioz", duke i thurë kryeheroit të "vërteta" legjendare. Në neoluftë, qëllimi është që vrasjet të jenë sa më pakë në numër, në mënyrë që fundi i saj të merret me çështje të viktimit, me çështje të humanizmit të kundërhënies, sepse ecjen e shoqërisë më tej përpara në histori, përnjëherë e për herë të parë në histori, po frenohet që mos ta uzurpojnë bredharakët dhe tregtarët e industrisë së kotë siç janë reklamat, turizmi dhe lëvizjet bredharake të njerëzve, duke thurë lëvdata se "janë vrasë kaq e kaq kundërshtarë". Jo, neolufta si filozofi humane shprehë dhembje për çdo viktimit dhe kjo shprehje nuk është moralizim, por njerëzi dhe virtyti. Kështu, paleolufta është fakt i njohur se i frynte xhepat e tregtarëve të topave dhe armëve të rënda, por edhe të atyre që tregtojnë armë të lehta e ku njerëzit vriten më lehtë se sa ta dëmtojnë një "pendës e rosës". E vërteta, edhe neolufta poseduesit e armëve i zbrazin stoqet e armëve të "demoduara", sepse ato janë të "vjetra", dhe duhet zëvendësuar me zbulime të reja, kur dihet se janë krijuar armë të "njerëzishme-intelig-

jente" (të dirigjuara). Prandaj, lufta për paqe, duhet të zhvillohet me fuqi më të madhe se sa ajo që ishte kundër paqes. Ky realitet, disi zbulohet në neoluftë, si një lloj parathënie e luftës klasike, të cilën duhet harruar një orë e më parë. Po si të harrohet, kur armët janë ato që janë shpikë edhe para 500 vjetëve e më tepër, por qëllimi i neoluftës është disi më "larg barotit", por më afër varrit. Kështu në proces neolufta, do të mësohet se ka zbuluar mundësinë e përdorimit të armëve "inteligjente". Edhe më qartë, deri sa ushtritë e mëdha, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XX, po përgatiteshin me buxhete marramendëse, madje edhe për një luftë atomike, fare pak kujt i kishte shkuar ndër mend se lufta e drejtë - neolufta e një ushtrie që do të quhet UÇK, ishte frika se do të shkaktojë Luftën e Tretë Botërore. Me gjithë këtë, edhe sot njerëzimit i kanë mbetur disa derivat të paleoluftës, sepse industria e armëve në shkallë marramendëse po krijon tensione, madje në mes civilizimeve, duke maskuar kundërshtarë thua se është fjala për luftë "religjioze" në mes civilizimeve.

Tash shtrohet pyetja, si ta shndërrojmë luftën paqësore në liri sovranë në Kosovë, varet si jemi të strukturuar për t'i ruajtur vlerat e luftës sonë të drejtë, vlerat logjike dhe rreshtimin tonë historik kah pavarësia e njëmendët, duke e bërë atë më të bindshme, më të vendosur se kurrë më parë për objektivin e lirisë. Nëse bazohemi në disa rrethana që na servohet, disi del se filozofia e Luftës së drejtë, prapë në disa meridianë të botës po ndrydhët si në të kaluarën. Dhe shembujt po i krijojnë magnetat e prodhimit të armëve, të cilat pa "teatrizimin" e krizave, do të shuheshin dhe pastaj nga ajo punëtori "vrastare" që punon nëpër ato fabrika, do të shkaktonte revolucione sociale të cilat pastaj kanë pasoja politike. Në këtë nyje politika prapë po prinë në "fabrikimin e krimeve", sepse nuk mund të sundojë pa to. Dhe pikërisht, revolucionet e mundshme po i largojnë kurdisjet e luftërave lokale dhe katastrofat e refugjatëve që janë të "teledirigjuara", që të ndodhin sa më larg froneve të përjetshme koloniale.

Në këtë rrethana, ata individë

dhe ato grupacione politike dhe religjioze, që janë mësuar të përfitojnë në paleoluftë, për këto 16 vite të shekullit XX, shihet se nuk kanë gjë të zezë pa përdorë për ta komprometuar neoluftën (UÇK-në). Dhe, në këtë fushatë, nuk është me rëndësi faji dhe dënimi, por kauza dhe përgojimi, pale rena pastaj e përsëritur nga dikush do të përvetësohet. E përvetësimi i rrenës, pastaj si zejtari i vjetër, dihet se do ta përfshijë palën kundërshtarë, pjesën e popullit viktimit. Kështu, në rastin e Kosovës, ajo pjesë që nuk sajón akuza, frikohet që e vërteta mos të zbulohet kurrë (drejtuesit e politikës pacifiste), sepse retroaktivisht del se i ka lidhë 12 marrëveshje me okupatorin dhe do të bëhet bashkëfajtorë për të gjitha krimet të kujt do qofshin. Ne jemi dëshmitarë se çfarë fjalori është përdorë, madje edhe nga njerëz tanë të tanishëm ndaj UÇK-së. Ai fjalor, në shumë raste nuk ishte i tyre, por e kishin sajuar nga bisedat që i kishin bërë disa orë, ose disa ditë para se t'i dëgjonim me veshët tanë, me qenien tonë që ishte e vendosur të sakrifikojmë çdo gjë për liri, çdo gjë për fitore, çdo gjë për ta penguar çdo krim, duke respektuar çdo gërmë të Konventave të Gjenevës, madje plus duke u bazuar në zakonet tona të lashta të luftës për liri: "Asnjë kundërshtar nëse zihet rob nuk guxon të poshtërohet, të vritet, ose të shfaroset, pa u bërë gjyqi, pa u njoftuar ndërkombëtarët" (Komiteti i Kosovës, Programi i Luftës më 1919). Po a ishte shembull edhe Lufta jonë për liri më 1910-1912 e drejtuar

nga Hasan Prishtina e që ushtronte këtë shkollë humane dhe kulmore civilizuese.

Sot, luftën e UÇK-së janë kah e hulumtojnë në "qetësi" shumë qendra të dy shkollave më të avancuar në botë. Me një anë, lufta e UÇK-së është kah konceptualizohet me një logjikë kibernetike për nevoja eksplikative doktrinare dhe taktike mbrojtëse, me një logjikë të universalizmit iluminist, me një vërejtje se kjo luftë, nuk mund të shkojë më larg se sa te stacioni i të drejtave të njeriut. Kjo është njëra anë e hulumtimit. Me këtë filozofi vërehet pa dilema se Kosovës do t'i mungojnë premiset e pavarësisë së plotë edhe për një kohë, madje jo të shkurtër. Këto premisa janë aq të dëshiruara për palën që shpreson, se do të kthehet historia prapa, madje shumë shpjet, madje shumë më lehtë se sa që është programuar, madje shumë më lehtë kur përplasen faktorët brendshëm, që shpijnë ujë në këtë "shkollë të shkretëtirës". Këtu, në këtë shembull dalin por si vullkan shembujt e luftës për ta varrosë lartësinë e neoluftës, siç duket në mënyrë konkave me rasti e Krimesë. E pra, duhet të thuhet se rasti i Kosovës nuk është "sui generis", por është rezultat i një lufte të drejtë 100-vjeçare që është zhvilluar në forma të ndryshme dhe ajo luftë ka qenë e njohur dhe e programuar (Programi Komitetit Kosovës 1878-1958; LRBSH 1956-1964-1999). Dhe, kjo luftë kurrë nuk ka qenë ilegale. Politika po, por lufta është bërë me armë dhe për liri. (Vijon)





PROGNOZA SPORTIVE

GUINGAMP - MARSEILLE

3+

LENS - AUXERRE

GG

ANTALYASPOR - ISTANBUL

2

Drita e mobilizuar për fitore ndaj '89-shit

Drita po synon fitore në ndeshjen e parafundit ndaj Trepçës '89 në mënyrë që ta mbajë diferencën e pikëve me skuadrën e Prishtinës. "Trepça '89 e ka një ekip shumë të mirë dhe kualitativ. Futbollistët e saj janë me përvojë të madhe, prandaj kemi respekt maksimal për këtë skuadër. Ndeshja ndaj '89-shit është e fundit për ne në shtëpi dhe normalisht se dëshirojmë ta mbyllim me fitore, pasi në këtë mënyrë jemi edhe më afër titullit të kampionit sesa që është synimi i klubit tonë", ka thënë Fidan Gërbeshi



sa më të madh për të na mbështetur, sepse me mbështetjen e tyre ne i fitojmë më lehtë betejat", ka thënë Gërbeshi për "Epokën e re".

Skuadra e Trepçës '89, që është kampione e elitës, i ka humbur shanset për ta mbrojtur titullin e fituar një vit më parë, por në këtë ndeshje synimet e kësaj skuadre janë të mëdha. Përparim Islami ka thënë të mërkurën për gazetë se skuadra nga Mitrovica nuk do të shkojë në Gjilan vetëm sa për ta zhvilluar ndeshjen. "Jemi të

kompletuar për sfidën kundër Dritës, kurse udhëtojmë në Gjilan për rezultat pozitiv. Pavarësisht se jemi jashtë garës për titull, jemi të motivuar për këtë ndeshje, pasi luajmë kundër një skuadre shumë të fortë dhe normalisht se dëshira është për rezultat pozitiv", ka thënë Islami. Sot (e premte), krahas ndeshjes Drita - Trepça '89, zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera: Prishtina i shkon Lirisë në Prizren, kurse Llapi e pret Flamurtarin në Besianë.

Vala SUPERLIGA / Java e 32-të

Të premten takohen:

Drita - Trepça '89

Liria - Prishtina

Llapi - Flamurtari

Të shtunën takohen:

Gjilani - Drenica

Feronikeli - Vëllaznimi

Të dielën takohen:

Vllaznia - Besa

(Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 16:00)

MKRS-ja, 12 mijë euro Majlinda Kelmendit



PRISHTINË, 10 MAJ - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, sot ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me xhudisten Majlinda Kelmendi, për mbështetje financiare të sportistes në vlerë prej 12 mijë eurosh. Sipas njoftimit të MKRS-së, qëllimi i mbështetjes financiare të xhudistes Majlinda Kelmendi bëhet për realizimin e objektivave dhe synimeve për vitin 2018, duke u bazuar në politikat programore të sportit

për avancimin e sportit cilësor dhe zhvillimin e aktivisteve sportive të karakterit ndërkombëtar brenda dhe jashtë vendit. Ministri Gashi e vlerësoi se kjo mbështetje financiare për sportistët që arrijnë rezultate kulmore siç është rasti i medalistës olimpike Majlinda Kelmendi është një lloj mirënjohje nga shteti dhe një nxitje për prezantim e përfaqësim sa më cilësor të shtetit tonë në arenën ndërkombëtare në fushën e

sporti, e cila edhe ndihmon në ngritjen e imazhit të shtetit tonë anekënd botës.

Xhudistja Majlinda Kelmendi falënderoi ministrin Gashi për mbështetjen e vazhdueshme që MKRS-ja po jep jo vetëm për të personalisht, por edhe për xhudistët e tjerë të Kosovës. Kelmendi premtoi se Kosovës do t'i sjellë edhe medalje të tjera dhe me punën e saj, emrin e shtetit tonë do ta afirmojë edhe më shumë.

Hasani priti delegacionin e FBBFK-së, pas suksesit në Spanjë

PRISHTINË, 10 MAJ - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Besim Hasani, ka pritur të enjten delegacionin e Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnesit të Kosovës (FBBFK), i prirë nga kryetari Esat Lata dhe sekretari i përgjithshëm, Sabri Dragusha. Kjo pritje është bërë pas suksesit të arritur javën e kaluar në Kampionatin Evropian të IFBB-

së, të mbajtur në Santa Sussana të Spanjës.

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe garuesit Besart Maxharraj, i cili zuri vendin e katërt në kategorinë +100 kg, dhe Edona Luta, e cila u rendit e pesta në Woman Body Fitness. Presidenti Hasani përgëzoi drejtuesit e federatës dhe garuesit për suksesin e arritur, duke iu uruar atyre suksese

edhe në garat e ardhshme.

Ndërsa kryetari i FBBFK-së, Esat Kata, ka thënë se federata që ai drejton do të mundohet t'i sjellë sa më shumë medalje vendit tonë. Edhe garuesit Maxharraj dhe Luta falënderuan presidentin Hasani për pritjen, duke premtuar se në kampionatet e ardhshëm do të arrijnë suksese edhe më të mëdha.



Edhe Delawie reagon për ndalimin e karateistëve të Kosovës

PRISHTINË, 10 MAJ - Ekspedita e Kombëtares së Kosovës në Karate të mërkurën nuk është lejuar dy herë të hyjë në shtetin e Serbisë. Policia serbe, me vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme të

Serbisë, nuk ka lejuar karateistët e Kosovës të hyjnë në Serbi për të marrë pjesën në Kampionatin Evropian, i cili do të mbahet nga 10 deri më 13 maj në Novi Sad. Lidhur me këtë ndalesë është deklaruar

edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie. "Normalizimi i marrëdhënieve duhet të paktën të thotë se atletët e rinj, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të

tyre, janë të lirë të konkurrojnë në garat ndërkombëtare. Është e trishtuar t'i shohësh ëndrrat e tyre të shkatërruara nga politika ndërkombëtare mbi të cilat nuk kanë kontroll", ka shkruar Delawie në "Twitter".



Tovërlani: Dështim nëse Prishtina nuk e fiton titullin

Prishtinë, 10 maj - Trajneri më i trofeshëm në futbollin e Kosovës, Afrim Tovërlani, ka folur për rrjedhën e kampionatit të sivjetmë si dhe për titullin e kampionit në Vala Superligë. Tovërlani fillimisht ka analizuar rrjedhën e këtij kampionati duke e cilësuar tejet interesant megjithëse, sipas tij, në pranverë ritmi i ekipeve ra dukshëm. "Sezoni vjeshtor ka qenë më rivalizuesi deri më tani, por sezoni pranveror nuk ka qenë i mirë, duhet ta kemi parasysh, sepse dështuan disa ekipe si Feronikeli, Trepça '89, Llapi, Gjilani dhe Liria. Pra, pranvera ka zbehur bukurinë dhe rivalitetin që ka qenë në vjeshtë. Patëm shumë ndeshje defanzive në pranverë nga skuadrat, gjë që e bën monotone lojën e futbollit", ka thënë Tovërlani për "Sport-24h.net".

